



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për bujqësi, pylltari, mjedis dhe planifikim hapësinor

Mbledhja nr. 37

Prishtinë, më 13.4.2016, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

i mbledhjes së komisionit për bujqësi, pylltari dhe mjedis e planifikim hapësinor

Në mbledhje morën pjesë : Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Srdjan Popoviq,
Emilija Redzeqi, Shaip Muja.

Munguan : Haxhi Shala, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Duda Balje**, kryetare e komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 6.4.2016,
3. Shqyrtimi i prioriteteve të ministrisë së bujqësisë, i ftuar ministri,
4. Te ndryshme ;

Kryesuesja **Duda Balje** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje.

2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 6.4.2016

Procesverbali nga data 6.4.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës së MB dhe prioriteteve, i ftuar ministri

Kryesuesja përshëndeti dhe falënderoj ministrin **Memli Krasniqi** në përgjigje të ftesës së komisionit dhe propozoi që i njëjti fillimisht të raportoi në pika të shkurta në mënyrë që pastaj anëtarët e komisionit të parashtrojnë pyetje ose dilemat për bashkëbisedim. Ministri poashtu falënderoj për ftesë dhe bashkëpunim duke filluar raportimin sipas agjendës së punëve në MB, sidomos për ndihmën që i dedikohen fermerëve të cilët dëshirojnë të janë pjesë e programeve dhe të cilët gjithnjë e më tepër po aplikojnë me numër rekord deri tani, por edhe MB e cila gjithnjë e më tepër po arrin të shpërndaj këto benefite atyre që meritojnë. Ministri sqarimin e mëtejme vazhdoi për buxhetin e planifikuar për vitin 2016 dhe shpërndau dokumentin e përgatitur në formë të fletushkës nga ana e MB ku janë shënuar saktësisht detalet rreth programit të pagesave direkte për vitin 2016 përkatësisht për 46 milion të planifikuara për fermerët që tanimë arrijnë numrin 40.000. Numri total i përfituesve nga grantet e MBPZHR-së është 389 në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Në angazhimet e tjera këtë vit për herë të parë është bërë një kompensim i dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe erërat. Në ndërkohë tha se është finalizuar masa e përhershme të kompensimit të dëmeve në bujqësi, që do të jetë një masë e hapur për aplikim gjatë gjithë vitit kurdo që të ketë fatkeqësi natyrore. Edhe për vërshimet e muajit mars priten raportet finale nga të gjitha komunat e prekura dhe sërish do të merret vendim në qeveri për kompensim të pjesshëm. Përkundër faktit që mungon një fond për kompensimin e dëmeve të shkaktuara në bujqësi, sidomos nga reshjet dhe vërshimet, ministri potencoi se do të ndërmerret një masë prej 500.000 euro. Sa i përket legjislacionit primar dhe sekondar ai theksoi shërbimet këshilluese të cilat tani janë plotësuar dhe kanë filluar punën këshilltarët e parë bujqësor, kurse për ligjin e ushqimit dhe pyjeve potencoi faktin se duhet të plotësohet legjislacioni për komunat rreth financimit publik e pastaj të shikohet sa mundet të ndikohet në kthimin e kompetencave në qendër apo sërish të mbeten nëpër komuna, gjithnjë në bashkëpunim me MF, sa i përket bashkëpunimit me MMPH rreth pyjeve dhe parqeve nacionale, jemi në rrugë të përafrimit të qëndrimeve, tha ai, në mënyrë që mos të krijohen probleme këtij komisioni gjatë shqyrtimit në kuvend. Një problem i mëhershëm sipas iniciativës së këtij komisioni, vazhdoi, rreth akreditimit të Institutit bujqësor në Pejë, është tejkaluar ngase ky institut është i akredituar rreth kontrolleve bujqësore, poashtu ndërtesa në renovim është në përfundim e sipër. Në aspektin e sfidave ai potencoi edhe numrin e pamjaftueshëm të stafit në Agjencinë për zhvillimin e bujqësisë.

Adem Salihaj falënderoj për raportimin e ministrit i cili raportim nuk mund të analizohet me një mbledhje të komisionit, por megjithatë ai kërkoj sqarime rreth problemeve kyqe siç janë ato buxhetore dhe të cilat nuk na bëjnë konkurrent në rajon, bujqit e rajonit vijnë apo eksportojnë prodhimet e tyre në vendin tonë, derisa fermerët tanë këtë dukuri vrojtojnë të pambrojtur dhe me demoralizim, në Bruksel deputetët informohen se vendet ballkanike nuk shfrytëzojnë grantet në mungesë të projekteve për çka mjetet financiare kthehen sërish atje, 4 projektligje që është dashur të hartohen që nga legjislacioni i kaluar ende nuk vijnë në parlament, raportet me Shqipërinë përkundër gjetjeve të ndryshme nga komisioni rreth problemeve të grurit etj nuk përmirësohen, kontrolli i produkteve kimike (plehu) është tejet i pakënaqshëm, pyjet gjenden në mëshirën e komunave të cilat nuk kanë inspektor (rajoni i Prizrenit ka vetëm dy inspektor bujqësor), përkundër faktit se ky komision ka monitoruar ligjin, ministria-qeveria nuk ka intervenuar ende me ndonjë akt nënligjor.

Emilija Redzeqi tha se ministri na dëshmoi sot një angazhim të MB por fatkeqësisht ende mbeten problemet e minoriteteve të cilët assesi nuk po mundën ti afrohen ndihmave apo granteve sikurse popullata shumicë, gjithashtu edhe sa i përket punësimit, përkundër faktit që sivjet ka kritere lehtësuese, me çka do të ndalohej emigrimi i popullatës pakicë.

Shaip Muja gjithashtu falënderoj dhe sugjeroj për hera tjera raportimet të bëhen me shkrim, në mënyrë që komisioni të njoftohet e pastaj të zhvillohet debati, kurse propozim konkret kishte një hartë të hartuar për MB i cili do ti shërbej në punën e saj për efikasitet më të lartë, kjo hartë do të krijoj përgatitjen tematike të MB për zhvillimin rural, inventarizimin e tokave bujqësore, eliminimin e kontaminimeve që ndodhin, gjithashtu vazhdoi me pyetje për shkollën profesionale Norvegjeze në Lipjan për edukimin veterinerë e bujqësor e cila duhet të jetë në kuadër të MB dhe MASHT si aset i RK, pse nuk regjistrohen barnat e veterinës dhe a mbahen diskutime publike për AUV, pse nuk bëhet asgjë për problemin e peletit, shfrytëzimi i kullosave, a ekziston koncepti për ligjin e ushqimit dhe agjencinë e ushqimit dhe a është vizituar ajo ndonjëherë nga ministri i MB, ai mbrojti qëndrimin e tij se kjo agjenci e ka vendin aty ku asht tani e assesi pranë MB. **Srdjan Popoviq** pyeti ngjashëm sikurse deputetja Redzeqi rreth bashkësive minoritare të cilët gjithnjë e më tepër janë të interesuar për inkuadrimin në bujqësinë kosovare por nëse ka mundësi edhe për subvencione që ofrohen nga ministria, ndaj pyeti sa është e lidhur ministria me këto bashkësi dhe si. **Murat Hoxha** fillimisht shrehu keqardhje për mos prezencën e përfaqësuesve të opozitës, te cilet merren drejtë për drejtë me fushën e bujqësisë ndërsa njëri është profesor i bujqësisë. Pjesëmarrja e tyre, vazhdoi, do të ishte mjaft e rëndësishme për vetë ata por edhe për komisionin, duke qenë se Ministri ka dhënë informacione mjaftë të rëndësishme dhe detaje lidhur me aktivitetet e Ministrisë. Ai ftoi ata që në të ardhmën të jen pjesë e punës së Komisionit.

Më tutje theksoi se nga diskutuesit e mëparshëm u përfshinë shumë çështje të cilat do ti shtroj edhe ai si pyetje, megjithatë kishte disa pyetje specifike për z. Ministër. E para, sa janë realizua rekomandimet nga raporti i komisionit e të miratuara edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Çështje tjetër me rëndësi është sa janë të ngritura kapacitetet e fermerëve, që nënkupton organizimi i trajnimeve në hartimin, konkurrimin dhe menaxhimin e projekteve. Pasi që Ministri ceku se kan dhënë grante dhe subvencione rreth 43 mil. Euro, ndërsa apostrofoi numrin e të punësuarve 1600 në mënyrë direkte dhe rreth 1000 në mënyrë indirekte. Duke ditë se për një vendë pune nevojiten 7500 deri në 10000 euro, dhe duke supozua që

mbështetja e ministrise të jetë 50%, del se janë investua diku rreth 8.000.000 që do të thotë që do të duhej të reflektonte një punësim prej mbi 10000 vetëve. Tjetër çështje e cila ishte zotim i ministrit nga viti i kaluar, është rregullimi i tokës me komasacion, çka është arritur në këtë aspekt. Pyetja tjetër kishte të bëjë me rindërtimin e të dhënave kadastrale respektivisht regjistrimin e tokave bujqësore në emër të pronarëve, duke ditë se numër i madh i pronave nuk i kanë të rregulluara çështjet pronësore në veçanti ato trashëgimore. Ndërsa një çështje e cila nuk u përmend nga ministri është dhënja e subvencioneve në kultivimin e arrës, kultivimi i së cilës është në rritje. Dhe në fund përkujtojmë se Komisioni është duke punuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin, pyetja ishte sa është ministria e involvuar në këtë çështje kur dihet se ligji ishte në shumë pika i vështirë.

Memli Krasniqi fillimisht rreth kërkesës për raportim me shkrim, ishte i pajtimit si të dëshiron komisioni, ndërsa për pyetjen e z. Salihaj rreth fondeve të BE pse ato nuk janë shfrytëzuar tha se në ato fonde Kosova nuk ka akses, në fakt ato janë fonde të IPARD 1, në të cilat pas akreditimeve që janë bërë shpresohet që së paku në IPARD 2 të ndërlihem me ndihmën e MF. Lidhur me pyetjen rreth projektligjeve të ministrisë tha se ministria mundet me i dërgua në afat shumë të shpejt por në atë mënyrë do të shkaktohen kokqarjet për parlamentin, sidomos ceku pyjet për të cilat MF duhet të shqyrtojë financat e komunave për kompetenca të mëtejme rreth pyjeve, sepse MB nuk ka deleguar kompetenca sipas dëshirës saj, për rekomandimet e inspekcioneve premtoi se do të zbatohen por tha se janë edhe disa përzierje të kompetencave në nivel të vendit, analizimi rreth plehrave, regjistrimit të produkteve dhe çështje të ngjashme janë në kompetencën e MB por siç tha ai kërkesat duhet të janë të thukta dhe sipas listës së aprovuar të KE. Ai falënderoi z. Muja për ofrimin e dokumentit për hartën e punës së MB ndërsa për AUV tha se MB nuk ka kompetencë mbi të por vetëm partneritet me të dhe çdo shtet që ka një funksionalitet normal, agjencinë e veterinarisë e ka afër ministrisë e jo kryeministrisë, për fragmentarizimet e tokës dhe eksproprijime tha se nuk është problemi që i harrova por për ato tema kanë mbetur shumë çështje të pazgjidhura nga e kaluara, krahura e dokumenteve kadastrale etj. Ministri kishte dialog me deputeten Emilija rreth minoritarve, por konstatoi se nuk ka diskriminim ngase ministria është transparente dhe konkurruese, qysh tani ata kanë filluar më tepër të aplikojnë, dispozitat ligjore janë mjaft të favorshme, 5 fermer mund të formojnë një njijsi dhe të përfitojnë, në vendin tonë, vazhdoi, ende mendojnë se kooperativat janë mbeturinë e së kaluarës, mirëpo kudo në Evropë bujqësia zhvillohet përmes tyre. Për synimet e z. Muja rreth shkollës së cekur potencoi se MB nuk ka kompetenca të mjaftueshme edhe pse trajnimet bashkërenditen dhe ka bashkëpunim, ndërsa “pse nuk e vizitoj AUV tregova më lartë edhe pse kemi marrëdhënie bashkëpunuese shumë të mira me këtë agjenci”. Ministri poashtu kishte polemik edhe me z. Muja rreth agjencisë veterinarë dhe funksionalizimit të sajë, për çka ai tha se kjo gjendje është si pasojë e asaj që MB është monitoruese e jo mbikëqyrse, kurse për barna veterinarë tha se AUV ceket në nenin e shtypur por nuk ka ingerenca direkte për MB. Në fund ministri falënderoj për ftesë dhe shtoi se ne duhet të pajtohemi për të mos u pajtuar por edhe një gjë duhet të dihet se nuk është zbuluar ndonjë shkop maxhik për zgjedhjen e problemeve.

4...Të ndryshme

Në pikën vijuese Kryesuesja propozoi **shqyrtimin e amendamenteve për Obiliqin** dhe ftoi komisionin për votimin e tyre, ndaj pas aprovimit u vendos që projektligji në fjalë të dërgohet për leximin e dytë.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje